



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija/Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, bazuar në vendimin e Ministres së MASHTI Nr. 01B/309 datë 13.07.2022 shpall:

### **KONKURS**

Për ndarjen e katërdhjetë (40) bursave për nxënësit e regjistruar në klasën e 10-të në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (shkolla profesionale) për vitin shkollor 2022-2023, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 136/2020. Njëzet (20) bursa për drejtimet deficitare dhe njëzet (20) për drejtimet teknike për vajza.

Ndarja e bursave për nxënës në IAAP nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) bëhet me qëllim të mbështetjes së nxënësve në profile të rëndësishme për tregun e punës.

Vlera e bursës është 50 euro në muaj, përkatësisht 500 euro për një vit shkollor. Nxënësit përfitojnë bursë për tri vite të shkollimit nëse vijnë me sukses mësimet në IAAP.

#### **Realizimi i të drejtës për bursë për drejtimet deficitare**

Të gjithë nxënësit të cilët regjistrohen në Arsimin profesional, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkurs, kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet deficitare, në këto profile:

- Teknik për dizajnin e mediave interaktive
- Instalues elektrik
- Veterinë
- Mekatronikë
- Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
- Automekanikë
- Hortikulturë

## **Realizimi i të drejtës për bursë në drejtimet teknike për vajza**

Të gjitha vajzat të cilat regjistrohen në Arsimin profesional, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkurs, kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet teknike, në këto profile:

- Metalpunes
- Instalues elektrik
- Instalues i ngrohjes, ujësjellësit dhe klimatizimit
- Automekanikë
- Teknologjia e riciklimit
- Energjetikë

### **Kushtet dhe kriteret e aplikimit për bursë:**

- 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- 1.2. Suksesi i shkollimit paraprak – klasat 6-9 (60%)
- 1.3. Rezultatet e testit të arritshmerisë (40%)

### **Dokumentacioni që kërkohet për aplikim:**

- Kërkesa për bursë, duke cekur edhe drejtimin për të cilin aplikon
- Dëftesën e shkollës së mesme të ulët (kopje)
- Certifikatën e lindjes

### **Procedurat e aplikimit**

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në IAAP (shkollë)
- Drejtorët e IAAP-ve i dorëzojnë aplikacionet përmes arkivit në MASHTI/DAAP deri me 05.10.2022
- Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen

Konkursi do të jetë i hapur prej **01.09.2022** deri **30.09.2022**.

**E drejta e ankesës:** Nxënësit që kanë aplikuar por nuk kanë përfituar, kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së rezultateve nga MASHTI. Ankesat shqyrtohen nga organi epror në MASHTI.